



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 13.06.2025  
Numër Protokoli: 4146/2025

A.nr.798/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës A.nr.798/2025 të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja J.B kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim pas ristrukturimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 13.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.798/2025, të datës 02.05.2025, të parashtruar nga ankuesja, J.B.

## A r s y e t i m

Nëpunësja civile, J.B (*më tej referuar vetëm* Ankuesja), e punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 02.05.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2927/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.798/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimit me numër protokoli 460, të datës 18.03.2025, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me transferimin pas ristrukturimit, nga pozita “Zyrtare për Buxhet dhe Financa” në pozitën “Zyrtare e Lartë për Çështje Financiare”.

Tutje, ankuesja më datë 26.05.2025, përmes shkresës me numër protokoli 3453/2025, është tërhequr nga ankesa me numër A.nr.798/2025 e datës 02.05.2025, për arsye se e njëjta po në këtë datë ka pranuar Vendimin me Nr.1166, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, përmes të cilit thekson se është transferuar në pozitën “Zyrtar i Lartë për të Hyra dhe Tarifa, në Divizionin për Menaxhimin e Pronave, Kyçjeve dhe Instalimeve, pretendim të cilin e kishte sipas ankesës së parashtruar në Këshill.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 26.05.2025, të ankueses për tërheqje nga ankesa A.nr.798/2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”*, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.798 /2025 të datës 02.052025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.798/2025**

**Atdhe GASHI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses J.B;
- Udhëheqëses së Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.